

HASAN BELLO

**MARRËDHËNIET E TENSIONUARA TË MBRETËRISË
SHQIPTARE ME REPUBLIKËN TURKE
(1928-1933)**

Marrëdhëniet e tensionuara shqiptaro-turke në vitet e para të shpalljes së Monarkisë deri më sot janë trajtuar përciptazi në historiografinë shqiptare. Edhe disa autorë që kanë patur rastin dhe janë përpjekur t'i marrin në shqyrtim këto raporte, nuk i kanë shpëtuar paragjyqimeve dhe kufizimeve ideologjike të kohës. Si rezultat, është arritur në konkluzione të njëanshme, duke fajësuar kryesisht vetëm Ahmet Zogun.

Duke u nisur nga kjo qasje e deritanishme, në bazë të dokumentacionit dhe burimeve relevante të kohës, më poshtë jemi përpjekur të hedhim një vështrim ndryshe, me qëllim për të evidentuar shkaqet e vërteta që çuan në tensionimin e këtyre marrëdhënieve, si dhe optikën e diplomacisë dhe të diplomatëve të huaj mbi këtë çështje.

*
* *

**Shpallja e Monarkisë në Shqipëri dhe refuzimi
i Ataturkut për ta njohur Mbretin Zog**

Presidenti Ahmet Zogu, i mbingarkuar me probleme të vështira të brendshme dhe të jashtme brenda një kohe të shkurtër kishte arritur deri diku të luftonte me sukses përçarjet dhe intrigat e huaja dhe ta fuste vendin në rrugën e zhvillimit ekonomik. Por, çdo ditë e më shumë, ai po bindej se një mbret në krye të Shqipërisë, ashtu siç kishte Anglia, Italia, Jugosllavia dhe Greqia apo vende të tjera evropiane, ishte më e vështirë të rrëzohej nga intrigat e huaja ose kryengritjet e brendshme se sa një president me një mandat të kufizuar qeverisjeje. Gjykohej se me një mbretëri të konsoliduar e të trashëgueshme do të sigurohej vazhdimësia e

regjimit të brendshëm në krahasim me pozitën e presidentit të republikës, që u ekspozojë tronditjeve të paparashikuara.¹

Më 5 gusht 1928, Ahmet Zogu në emër të qeverisë dhe deputetëve, me qëllim që shtetit shqiptar t'i jepej forma definitive në përputhje me traditën, psikologjinë, kushtet e brendshme dhe të jashtme, nxorri dekretin për t'u mbledhur Asambleja Kushtetuese me qëllim rishikimin e Kushtetutës.

Asambleja, më 1 shtator 1928, aprovoi njëzëri Kushtetutën e re, e cila sanksiononte edhe formën e regjimit duke e shpallur Shqipërinë si Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe të trashëgueshme, me Mbret të Shqiptarëve, Naltmadhërinë e tij Zogu I.²

Brenda një kohe të shkurtër të gjitha shtetet evropiane filluan ta njohin njëri pas tjetrit Mbretërinë Shqiptare dhe Mbretin Zog, me përjashtim të Jugosllavisë, e cila në emërtimin "Mbret i Shqiptarëve" shihte synimet për të përfshirë nën kurorën e tij popullsinë dhe territoret shqiptare që ndodheshin brenda kufijve të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene.³ Një qëndrim po aq absurd sa Jugosllavia mbajti dhe Turqia.

Më 1 shtator 1928, ambasadori turk në Tiranë, Tahir Lutfi beu, njoftoi Ministrinë e Punëve të Jashtme në Ankara, se "sot në ora 9:15 parlamenti shpalli monarkinë dhe Presidentin Ahmet Zogu si Mbret të Shqiptarëve me titullin Zogu i I-rë".⁴ Po në këtë datë, ambasadori i Turqisë në Londër njoftoi Ankaranë, se agjencia angleze e lajmeve "Central News" në bazë të një telegrami të ardhur nga Stambolli bënte të ditur se së shpejti edhe Mustafa Qemali do të vetëshpallej mbret.⁵ Në këtë linjë ishin dhe disa artikuj që u botuan në të përditshmet angleze "The Daily Telegraph",⁶ "Manchester Guardian"⁷ apo në disa gazeta franceze, të cilat, shkruanin se për këtë ai (Ataturku-H.B.) do të merrte si shembull Mbretin e shqiptarëve Ahmet Zogun. Ndërkohë që ambasada turke në Londër u urdhërua nga Ankaraja që t'i përgënjeshtronte lajmet e

¹ Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zogu I-rë*, Tiranë: 1996, f.213-214.

² Teki Selenica, *Shqipëria më 1937*, Tiranë: "Tirana", f.6-8.

³ Richard Busch Zautner, *Shqipëria nën regjimin e Zogut*, Leipzig: 1939, f.10, përkthim në: *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*) A-V-16.

⁴ Bilal N.Şimşir, *Atatürk ve yabancı devlet başkanları*, Cilt. I, Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1993, dok. nr. 379, s.292-293.

⁵ *Po aty*, dok. nr. 380, s.293.

⁶ "King Kemal? En Angora Report", *The Daily Telegraph*, 1.9.1928, p.1.

⁷ "Kemal to Follow Suit?", *Manchester Guardian*, 1.9.1928, p.1.

mësipërme.⁸ Mendimin e vet për këtë çështje Mustafa Qemali e bëri të qartë me datë 5 shtator, kur ai deklaroi në mënyrë të prerë se kurrë nuk do t'ia njihte regjimin e ri të Tiranës.⁹ Sipas konsullit të Shqipërisë në Stamboll, Kryetari i Republikës Turke kishte kritikuar veprën dhe dëshirën e kombit shqiptar në mes të rrethit të tij të përditshëm, në një mënyrë që nuk përputhej me dinjitetin e një burri shteti.¹⁰ Më 7 shtator 1928, gazeta gjysmë zyrtare “Cumhuriyet” (“Republika”) shkruante se “reaksioni i bërë në Shqipëri në këtë epokë, kur sovraniteti kombëtar mbizotëron si zot i vetëm në vendin tonë, ndër ne është pritur me habi dhe zemërim. Turqia duhet të tërheqë me të shpejtë përfaqësuesin e saj nga Tirana”.¹¹ Po kjo gazetë, më datë 10 shtator 1928, shpalljen e Mbretërisë në Shqipëri e ironizonte duke e quajtur atë si “Opereta e Tiranës”.¹²

Sipas informatave të përfaqësisë shqiptare në Ankara, ishte Mustafa Qemali ai që ngulte këmbë që Turqia të mos e njihte regjimin e ri mbretëror të Shqipërisë. Disa ministra, e midis tyre edhe ministri i Punëve të Jashtme, Tevfik Rüştü Aras (Teufik Ryshty Aras), i ishin lutur Kryetarit të Republikës për këtë çështje dhe ai përsëri kishte refuzuar.¹³ Sapo u kthye nga pushimet verore, Ataturku thirri në një takim urgjent përfaqësuesin e Turqisë në Tiranë Tahir Lutfi beun. Më 3 tetor 1928, atij, iu dërgua ky urdhër telegrafik: “Shkëlqesia e Tij, Presidenti, u kthye. I fola për ndryshimin e regjimit që ndodhi në Shqipëri. Pas kësaj ndodhie të rëndësishme, nga qeveria shqiptare nuk na u dhanë shpjegime të mjaftueshme. Prandaj, Shkëlqesia e Tij, ka nevojë të vini këtu (në Ankara-H.B.) për t'i dhënë informata të mjaftueshme për të gjithë këtë aventurë. Ju lutem të vini, duke shpjeguar në mënyrë të përshtatshme

⁸ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok. nr. 381, s.294. *The Turkish Embassy in London, to the Editors of The Times, The Daily Mail, The Manchester Guardian, The Daily Telegraph, The Daily Express, and The Reuters Ltd. London.*

⁹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 251, Viti (më tej: V.) 1928, Dosja (më tej: D.) 65, fl.169, Telegram i legatës shqiptare në Ankara, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 12.10.1928.

¹⁰ *Po aty*, fl.271, Telegram i konsullit shqiptar në Stamboll, Nezir Leskoviku, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 8.9.1928.

¹¹ *Cumhuriyet*, 7.9.1928, s.2.

¹² *Po aty*, 10.9.1928, s.2.

¹³ AQSH, F. 251, V. 1928, D.66, fl.30-32, Telegram i legatës shqiptare në Ankara, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 1.10.1928.

arsyen e udhëtimit tuaj”.¹⁴ Pas largimit të Tahir Lutfi beut, në Tiranë, si i ngarkuar me punë *ad interim* mbeti sekretari i Parë i Legatës, Fuad beu.

Mendimin e tij për çështjen e ndryshimit të regjimit në Shqipëri, Mustafa Qemali ia bëri të ditur edhe gazetarit të “Le petit Parisien” Henri Berro, të cilit, i deklaroi ndër të tjera se: “Si, ta miratoj mbretërinë shqiptare? Jo, jo! Mos më flisni për këtë, nuk e njoh. Njeriu nuk duhet ta tradhëtojë kombin e vet...!”¹⁵ Kjo intervistë e Mustafa Qemalit, dhënë për këtë gazetë franceze bëri jehonë të madhe dhe në shtypin anglez.¹⁶ Përfaqësia shqiptare në Ankara vinte në dukje, duke u bazuar dhe në një shkrim të botuar në gazetën turke “**Hakimiyet-i Milliye**” se **fjalët e botuara nga redaktori i gazetës** “Le petit Parisien”, nuk kishin qenë deklarata zyrtare të Kryetarit të Republikës Turke, por, vetëm biseda private.¹⁷ Megjithatë, kjo intervistë, jo vetëm që nuk u përgënjeshtroa ndonjëherë nga qeveria turke, por pas disa ditësh ajo u ribotua dhe në gazetën “Vakit” (“Koha”).¹⁸ Duke u nisur nga situata e krijuar ministri i Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, më 20 tetor 1928, thirri për një takim të ngarkuarin me punë të Turqisë në Tiranë, Fuad beun, të cilit, pasi i tregoi intervistën e dhënë nga Ataturku në gazetën franceze (dhe të ribotuar pak ditë më vonë edhe tek gazeta turke “Vakit”) i deklaroi se: “Ju keni përdorur një numër fjalësh të rënda për mbretin tonë, si ky farë burri. Ashtu siç i kam thënë dhe Tahir Lutfi beut, Shqipëria dëshiron që Turqia ta njohë mbretërinë, por në rast të kundërt, kësaj nuk i kushton rëndësi. Mos kini ndërmend të na shpallni luftë?”.¹⁹ Në fund të bisedës, Iliaz Vrioni i kërkoi diplomatit turk, që qeveria e tij të deklaronte me anë të shtypit se kjo intervistë, nuk ishte një deklaratë zyrtare dhe se nuk do të përcaktonte qëndrimin e qeverisë turke ndaj shtetit shqiptar.

E ndodhur përballë kritikave të tilla, qeveria e Tiranës e ndaloi hyrjen e gazetave e të revistave turke në territorin shqiptar.²⁰ I ngarkuari me

¹⁴ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok. nr. 384, s.296.

¹⁵ *Le petit Parisien*, 7.10.1928.

¹⁶ Shih: “Turkey and Albania”, *Financial News*, 8.10.1928; “Kemal’s Outburst”, *Morning Post*, 8.10.1928; “Turkey and Albania”, *The Daily Telegraph*, 8.10.1928.

¹⁷ *AQSH*, F.251, V.1928, D.66, fl.28, Telegram i legatës shqiptare në Ankara, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 19.10.1928.

¹⁸ *Vakit*, 11 Ekim 1928, s.1-2.

¹⁹ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok. nr. 389, s.300-301.

²⁰ Sipas raporteve të përfaqësisë turke në Tiranë që nga 11 shtatori 1928, hyrja e shtypit turk dhe ekspozimi i fotografive të Mustafa Qemalit në faqet e shtypit

punë i Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, më 19 tetor 1928, njoftoi ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni mbi mbërritjen atje të Tahir Lutfi beut. Pas një vizite që i kishte bërë atij në hotel, ai i kishte deklaruar se do të bënte çmos për zhdukjen e mosmarrëveshjeve midis dy shteteve dhe të njohjes së Monarkisë Shqiptare. Por, nuk kishte munguar të shfaqte gjithashtu edhe zemërimin e tij, mbi ndalimin e hyrjes së gazetave turke në Shqipëri, si dhe atakimin, që gjoja një gazetë shqiptare që dilte në Bari të Italisë, kishte bërë kohët e fundit kundër Turqisë. “Dhe kështu -vijonte me të drejtë Asaf Xhaxhuli- duke ditur fare mirë atakimet e tyre dhe më tepër personale e qesharake guxojnë dhe të ankohen”.²¹ Sipas tij, qëllimi i ardhjes së Tahir Lutfi beut në Ankara ishte se së shpejti, ai, priste të takohej me Ataturkun.

Më 1 nëntor 1929, Asaf Xhaxhuli, raportoi mbi vizitën e kthyer nga ana e Tahir Lutfi beut dhe se ai ende nuk kishte mundur të takohej me Ataturkun. Megjithëse ministri i Punëve të Jashtme Tevfik Rüştü Aras, rezervohej të takohej me diplomatin shqiptar dhe të bisedonte me të mbi njohjen e regjimit, nga sjelljet e tyre ndaj përfaqësisë shqiptare kuptohej lehtë, se i vetmi person që insistonte ishte Kryetari i Republikës Turke. Këtë gjë, Asaf Xhaxhulit, ia kishin bërë të ditur shumë personalitete dhe deputetë turq.²² Megjithatë, qeveria shqiptare mbante një qëndrim mospërfillës. Ajo i dha urdhër kategorik Asaf Xhaxhulit që të mos bënte asnjë demarsh pranë autoriteteve turke mbi këtë çështje.

Nga ana tjetër, mosnjohja e regjimit të ri shqiptar nga ana e shtetit turk, kishte ngjallur habinë e të gjithë ambasadorëve të huaj në Ankara. Duke u nisur nga kjo, ambasadori i Gjermanisë M.Nadolny, i deklaroi në një takim Asaf Xhaxhulit se sjellja e qeverisë turke ishte një sjellje jo vetëm e palogjikshme, por dhe qesharake. “Ju -vijoi më tej ai- duhet t`u jepni të kuptojnë turqëve se artikujt e shtypit francez, përsa i përket Mustafa Qemalit janë me prapaqëllim dhe manovra franceze. Pra, turqit

shqiptar ishte e ndaluar në mënyrë kategorike. Başbakanlık Cumhuriyet Arşivi (*Arkivi i Kryeministrisë së Republikës Turke*, më tej: *BCA*), 30 Aralık 1928, fon kodu: 030.10, yer no: 233.570.15: 11.

²¹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), D.66, V.1928, fl.28, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, 10.10.1928.

²² *Po aty*, fl.31, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, 1.11.1928.

nëse duhet t'i zemërohen, t'i zemërohen shtypit francez dhe Francës e jo Shqipërisë. Ndryshimi i regjimit të një shteti shumë herë u përgjigjet nevojave dhe interesave të atij vendi dhe të huajtë s'kan asnjë të drejtë të përzihen. Bashkë me këtë, dihet mirë se Gazi Mustafa Qemali, për Shahun e Persisë nuk tregoi ndonjë pengim të tillë".²³ Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe, Sir Xhorxh Klerku, mbasi kishte shfaqur po ashtu habinë e tij, i deklaroi Asaf Xhaxhulit tekstualisht këto fjalë: "Këto që bëjnë turqit janë reklama dhe s'kanë ç'bëjnë, shumë shpejt do ta njohin".²⁴

Studiuesi Gazmend Shpuza ka shkruar se qëndrimi mosmiratues që mbajti Mustafa Qemali ndaj shpalljes së Mbretërisë Shqiptare ishte "një qëndrim i drejtë, që përputhej si me parimet e tij republikane ashtu edhe me interesin e të dyja palëve për ruajtjen e për forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-turke".²⁵ Duhet theksuar fakti se, së pari, ndryshimi i formës së regjimit të një shteti është një e drejtë legjitime, në përputhje me aspiratat, dëshirat dhe nevojat e një populli dhe që s'duhet të interferojë aspak në relatat midis dy vendeve; së dyti, fakti që Mustafa Qemali nuk i përmbahej të njëjtave parime si në rastin e Persisë, tregon se ai gjykonte me standarde të dyfishta, duke u nisur nga një mentalitet perandorak që akoma vazhdonte ta konsideronte Shqipërinë, jo si një entitet të pavarur politik, por si një shtet satelit të Turqisë; së treti, mosnjohja e regjimit të ri të Shqipërisë edhe nga vetë pjesa dërrmuese e lidërshiptit politik të Turqisë, më shumë se sa çështje parimesh konsiderohej si një kapriço politike e Mustafa Qemalit. Një qëndrim i tillë nuk i shërbeu aspak forcimit të marrëdhënieve shqiptaro-turke. Përkundrazi, futi elementë të panevojshëm që çuan në uljen e nivelit të marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Prandaj, çdo përpjekje për të justifikuar këtë qëndrim absurd të Ataturkut, jo vetëm që është i pabazuar, por bie ndesh si me teorinë ashtu edhe me praktikën e së drejtës ndërkombëtare.

Për njohjen e Monarkisë Shqiptare nga ana e Turqisë, edhe Roma filloi një fushatë aktive diplomatike. Më 11 shtator 1928, Musolini urdhëroi ambasadorin italian Orsini Baroni, që të ndërhynte tek ministri i Jashtëm Tevfik Rüştü Aras, që ai ta bindte Ataturkun për t'a njohur Mbretërinë e re të Shqipërisë. Kjo gjë, sipas tij, do të përbënte një akt

²³ *Po aty*, fl.32.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ Gazmend Shpuza, *Ataturku dhe shqiptarët*, Tiranë: "Dituria", 1994, f.70.

miqësie ndaj Italisë dhe do të ndikonte që edhe shumë shtete të tjera ta njihnin Mbretërinë Shqiptare.²⁶ Sipas Musolinit, kjo do të shërbente gjithashtu për t'i dhënë fund një periudhe të gjatë tranzicioni, e cila po të zgjaste më tej, do të bëhej shkak për lindjen e trazirave në të gjithë hapësirën ballkanike. Pas disa ditësh, ambasadori italian në Turqi, i raportoi Musolinit se në bisedën e zhvilluar me Tevfik Rüştü Aras, ky i fundit i kishte lënë të kuptohej se ishte shumë i shqetësuar për ndonjë marrëveshje të mundshme mes Francës dhe Italisë dhe në mënyrë të veçantë për mosnjohjen e Monarkisë Shqiptare nga Ataturku. Një rol të madh në acarimin e marrëdhënieve me Shqipërinë, sipas ministrit turk, kishte luajtur shtypi anglez dhe francez. Shtypi i këtyre vendeve, megjithëse nuk kishte patur ndikim brenda Turqisë, sepse shtypi atje ishte i kontrolluar, kishte shërbyer për forcimin e kundërshtarëve të Ataturkut që ndodheshin jashtë Turqisë. Ambasadori italian, shkruante se i kishte thënë ministrit turk: “ne e dimë se ju keni qenë gjithmonë pro, por ka kundërshtuar Ataturku dhe se Ismet Pasha bashkë me ty jeni të detyruar të mbronni pozicionin e Ataturkut, pavarësisht se jeni kundra”.²⁷ Ndërsa ai, i ishte përgjigjur se Ataturku nuk e njihte Monarkinë Shqiptare, jo se ishte kundër këtij vendi, por sepse nuk dëshironte t'u jepte shkas thashethemeve, sipas të cilave, ai kërkonte të bëhej mbret i Turqisë. Pra, ky gjest i mosnjohjes së Shqipërisë nuk kishte aspak karakter antiitalian. Orsini Baroni ishte i mendimit se herët a vonë Ismet Pasha dhe Tevfik Rüştü Aras beu do të arrinin të krijonin aq afërsi me Ataturkun sa që të ndikonin tek ai për të njohur regjimin e ri të Shqipërisë. Tevfik Rüştü Aras i kishte premtuar atij se do të angazhohej seriozisht dhe se do të muntohej për të shmangur çdo lloj pengese mes Turqisë dhe Shqipërisë.²⁸

Qeveria turke, vazhdoi të mbante një qëndrim të ftohtë ndaj përfaqësisë shqiptare në Ankara. Me rastin e 28 nëntorit, kur Legatën Shqiptare e vizituan për të shprehur urimet e tyre të gjithë ministrat e huaj, nga autoritetet turke nuk kishte shkuar askush. Përveç ministrit të Mbrojtjes Kombëtare, Mustafa Abdylhalik beut që ishte shqiptar me

²⁶ *Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: *DDI*), Seria 7, vol. VII, dok. nr. 643, p.563, Telegram i Musolinit, për ambasadorin e Italisë në Stamboll Orsini Baroni, 11.9.1928.

²⁷ *Po aty*, dok. nr. 63, p.71, Telegram i Musolinit, për ambasadorin e Italisë në Stamboll Orsini Baroni, 11.11.1928.

²⁸ *Po aty*, p.72-73.

origjinë nga Janina, i cili, kishte dërguar me anë të shefit të kabinetit kartvizitën e vet në shenjë urimi.²⁹ Këtij qëndrimi edhe përfaqësia shqiptare nuk vonoi dhe iu përgjigj në mënyrë reciproke. Duke refuzuar një ftesë që Sekretari i Përgjithshëm i Kryetarit të Republikës Turke i bëri Asaf Xhaxhulit, me të cilën e ftonte në emër të Mustafa Qemalit, të merrte pjesë në pritjen që do të organizonte ky i fundit në datën 16 janar 1929, me rastin e martesës së vajzës së tij të adoptuar.³⁰ Diplomatët shqiptarë përpiqeshin të evitonin çdo kontakt me funksionarët dhe administratën turke, gjë, që kishte shkaktuar vështirësi të mëdha si nga pikëpamja e funksionimit të legatës ashtu dhe nga pikëpamja e marjes së informacionit. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto vështirësi, Asaf Xhaxhuli, i lutej Ministrisë së Jashtme në Tiranë, që t'i komunikonte një urdhër të prerë mbi sjelljen e përgjithshme dhe definitive të trupit diplomatik shqiptar.³¹ Përgjigjja e Tiranës nuk vonoi, sipas saj Legata Shqiptare, duhet të vazhdonte të mbante të njëjtin qëndrim, domethënë të evitonte çdo kontakt me autoritetet turke, me përjashtim të përfaqësuesve të shteteve të tjera, me të cilët duhet të mbante marrëdhëniet që kishte pasur më parë.³²

Më 24 shkurt 1929, konsulli i Shqipërisë në Stamboll, Nezir Leskoviku, raportoi se në një pritje të organizuar nga ambasada gjermane, ambasadori i Austrisë, August Kral i kishte deklaruar në mënyrë konfidenciale lidhur me një bisedë që kishte zhvilluar po atë ditë me Teufik Ryshty beun, ku ndër të tjera e kishte pyetur këtë të fundit se: “Me të gjitha shtetet e huaja e sidomos me ato të Ballkanit jeni duke lidhur marrëveshje të ndryshme dhe po ndërtoni relacione të mira. Po me Shqipërinë ç'po bëni? Sepse, unë si dashamirës i të dyja palëve më intereson të shoh dy popuj të cilët janë destinuar të jenë gjithmonë në

²⁹ *AMPJ*, D.66, V.1928, fl.33. Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, 29.11.1928.

³⁰ *Po aty*, fl.37, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për zëvendësministrin e Punëve të Jashtme, Milto Tutulani, 17.1.1929.

³¹ *Po aty*, D.463, V.1929, fl.2, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për zëvendësministrin e Punëve të Jashtme, Milto Tutulani, 12.2.1929.

³² *Po aty*, fl.5, Letër e zëvendësministrit të Punëve të Jashtme, Milto Tutulani, për legatën shqiptare në Ankara, 4.3.1929.

miqësi të ngushtë me njëri-tjetrin”.³³ Ndërsa Tevfik Rüştü Aras i ishte përgjigjur se: “keni të drejtë, por, kjo çështje ka të bëjë më shumë me politikën tonë të brendshme dhe për këtë arsye jemi të detyruar të presim dhe pak. Bashkë me këtë s`ka dyshim se së shpejti kjo çështje do të marrë fund...”.³⁴

Si ministri i Punëve të Jashtme, Tevfik Rüştü Aras ashtu dhe një pjesë e mirë e funksionarëve të administratës turke, përpiqeshin, megjithë distancën e krijuar si rezultat i qëndrimit kokëfortë të Ataturkut, të ruanin një farë klime miqësie me përfaqësinë shqiptare në Ankara.

Më 13 prill 1929, i ngarkuari me punë Asaf Xhaxhuli, raportoi se me rastin e nisjes së Teufik Ryshty beut dhe delegacionit turk në Konferencën e Çarmatimit, e cila do të mbahej në Gjenevë, për t'i përcjellë kishte asistuar i gjithë trupi diplomatik. Si këtë herë edhe në raste të tjera, në kundërshtim me indiferencën dhe neglizhencën e përfaqësuesit të Shqipërisë, autoritetet turke nuk e kishin përjashtuar këtë legatë në asnjë ftesë e ceremoni.³⁵

Tërheqja e ministrit turk, Tahir Lutfi beut nga Shqipëria u shoqërua në shenjë reciprociteti me tërheqjen e ministrit Shqiptar Rauf Fico, të cilin Mbreti Zog e emëroi si ministër të Punëve të Jashtme në kabinetin e ri qeveritar. Ky akt, shënoi edhe uljen e nivelit të marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve, në shkallën e të ngarkuarve me punë, detyrë që do të kryhej nga sekretarët e legatave përkatëse.³⁶

Më 26 prill 1929, Nezir Leskoviku, raportoi nga Stambolli se në një pritje të organizuar me rastin e përvjetorit të kurorëzimit të Shahut nga konsullata e Persisë, konsulli i përgjithshëm i Greqisë Saqillaropullos, i kishte deklaruar atij se kishte informacione që Partia Popullore e Turqisë (partia e Ataturkut-H.B.) më në fund kishte vendosur ta njëhte regjimin monarkik të Shqipërisë.³⁷ Nezir Leskoviku, raportoi gjithashtu se kohët e fundit gazetatat turke kishin filluar ta ndyshonin qëndrimin e tyre ndaj Shqipërisë. Kjo, dukej dhe nga fakti se ato kishin filluar të përdornin

³³ *Po aty*, fl.6, Letër e konsullit të Shqipërisë në Stamboll, Nezir Leskoviku, për zv. Ministrin e Punëve të Jashtme Milto Tutulani, 24.2.1929.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *Po aty*, fl.16, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për zëvendësministrin e Punëve të Jashtme, Milto Tutulani, 13.4.1929.

³⁶ G. Shpuza, *Ataturku...*, f.66.

³⁷ *AMPJ*, D.463, V.1929, fl.20, Letër e konsullit të Shqipërisë në Stamboll, Nezir Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Rauf Fico, 26.4.1929.

fjalën Kral (Mbret-H.B.) për Lartmadhërinë e Tij, Mbretin Zog I, fjalë të cilën më parë nuk kishin dëshirë ta artikulonin aspak nëpër shkrimet e tyre.³⁸

Në një vizitë që Asaf Xhaxhuli, i bëri ambasadorit të Italisë, Orsini Baroni më 18 maj 1929, ky i fundit i tregoi mbi një bisedë që kishte zhvilluar në Romë me Tevfik Rüştü Aras, lidhur me njohjen e regjimit të Shqipërisë. Ndër të tjera, ai e kishte pyetur ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, për një artikull që kishte lexuar në një gazetë franceze, sipas së cilës, Ankaraja do të tërhiqte edhe të ngarkuarin me punë nga Tirana. Tevfik Rüştü Aras jo vetëm që e kishte përgënjeshtuar një gjë të tillë, por, i kishte deklaruar atij se përkundrazi, personalisht ai po përpiquej me të gjitha forcat, për të përmirësuar marrëdhëniet shqiptaro-turke.³⁹

Këmbënguljes së Ataturkut për mosnjohjen e Monarkisë Shqiptare i bashkangjitej dhe një qëndrim tjetër absurd. Nga ana tjetër, ai përpiquej t'a respektonte në maksimum trupin diplomatik shqiptar, duke e ftuar atë në të gjitha ceremonitë e organizuara nga Presidenca. Por, meqë ftesave në fjalë diplomatët shqiptarë i përgjigjeshin me neglizhencë dhe indiferencë të vazhdueshme, vetvetiu kjo krijoi një ftohje akoma më të madhe. Pas refuzimit të disahershëm, pala turke, filloi të mos u dërgonte më ftesa.⁴⁰

Më 23 shtator 1929, sekretari i Kryekonsullatës Shqiptare në Bari të Italisë, i ankohej ministrit të Jashtëm Rauf Fico se, disa konsullata turke vepronin në kundërshtim me marrëveshjen e reciprocitetit të nënshkruar më 6 shtator 1926, që parashikonte dhënie vize gratis për studentët, nënpunësit dhe udhëtarët e varfër të të dyja vendeve.⁴¹ Duke u nisur nga kjo, Ministria e Jashtme me anë të një qarkoreje, në fund të muajit shtator, urdhëroi të gjitha konsullatat shqiptare për shfuqizimin e kësaj marrëveshjeje dhe që të gjithë nënshtetasve turq që do të kërkonin viza shqiptare, t'u merrej taksa e zakonshme, në bazë të tarifës konsullore që ishte në fuqi.⁴²

³⁸ *Po aty*, fl.21.

³⁹ *Po aty*, fl.33, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme Rauf Fico, 19.5.1929.

⁴⁰ *Po aty*, fl.30, Letër e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Ankara, Asaf Xhaxhuli, për ministrin e Punëve të Jashtme, Rauf Fico, 30.5.1929.

⁴¹ *Po aty*, D.540, V.1929, fl.1, Letër e sekretarit të Kryekonsullatës Shqiptare në Bari të Italisë, për ministrin e Punëve të Jashtme Rauf Fico, 23.9.1929.

⁴² *Po aty*, fl.2, Qarkore e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për konsullatat shqiptare lidhur me shfuqizimin e marrëveshjes mbi vizat me Turqinë, shtator 1929.

Me rastin e mbylljes së përfaqësisë shqiptare në Ankara, i Ngarkuari me Punë i Shqipërisë, Asaf Xhaxhuli, më 8 tetor 1929, i bëri një vizitë lamtumire ministrit të Punëve të Jashtme, Tevfik Rüştü Aras, të cilit i deklaroi se, shkak i mbylljes së përfaqësisë shqiptare ishin “shkaqet financiare” dhe se nga Turqia po largohej me ndjenjat më miqësore.⁴³ Ndërsa konsulli shqiptar në Stamboll, Nezir Leskoviku, i deklaroi shtypit turk se mbyllja e përfaqësisë shqiptare në Ankara s`do të thoshte se marrëdhënieve shqiptaro-turke do t`u jepej fund.⁴⁴ Ndryshe nga pala shqiptare, me përjashtim të konsullatës së Vlorës, Turqia nuk e mbylli Legatën e saj në Tiranë. I ngarkuari me Punë i Turqisë, i raportoi Ankarasë më 14 tetor 1929, se përpara se të nisej për pushime drejt Turqisë, ai i kishte bërë një vizitë ministrit të Jashtëm Rauf Fico, i cili, i kishte folur me shumë simpati për Turqinë dhe me respekt të veçantë për Ataturkun. Ministri shqiptar i kishte përsëritur atij edhe një herë faktin se përfaqësinë e kishin mbyllur për arsye financiare dhe se në janarin e ardhshëm, do të dërgonin përsëri një të ngarkuar me punë.⁴⁵

Mbyllja e përfaqësisë shqiptare në Ankara, shkaktoi jehonë të madhe në Turqi. Shtypi turk filloi të fliste edhe për mbylljen e konsullatës shqiptare në Stamboll dhe se detyrat e saj për mbrojtjen e popullsisë shqiptare do t`i ngarkoheshin konsullatës italiane. Nezir Leskoviku në një letër që i drejtoi Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë ankohej se, kjo gjë do ta zemëronte tejmase koloninë shqiptare të Stambollit dhe se ishte i mendimit që kjo konsullatë jo që s`duhej të syprimohej, por, duhej të forcohej akoma më shumë, duke e ngritur në rang kryekonsullate, ashtu si dhe shoqet e saja në këtë qytet. Kjo gjë, sipas tij, do të ndikonte që Turqia ta kuptonte akoma më mirë gabimin që kishte bërë, duke mos e njohur regjimin shqiptar.⁴⁶

Më 9 janar 1930, Legata Shqiptare në Londër njoftoi se gazeta “Belfast News Letter” kishte botuar një artikull mbi marrëdhëniet turko-shqiptare. Sipas saj, Musolini në vizitën që Tevfik Rüştü Aras kishte bërë së fundmi në Romë, i ishte lutur atij të bënte ç`ishte e mundur për të

⁴³ *Cumhuriyet*, 9 Ekim 1929, s.3.

⁴⁴ *AQSH*, F.251, V.1929, D.151, fl.76, Letër e konsullit të Shqipërisë në Stamboll, Nezir Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Rauf Fico, 18.10.1929.

⁴⁵ *BCA*, 14 Ekim 1929, 030.10, 233.570.13.

⁴⁶ *AMPJ*, D.463, V.1929, fl.77, Letër e konsullit të Shqipërisë në Stamboll, Nezir Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Rauf Fico, 19.11.1929.

siguruar njohjen e Mbretërisë Shqiptare nga ana e Turqisë dhe, për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve.⁴⁷

I larguar për “pushime”, i Ngarkuari me Punë i Turqisë do të kthehej në Tiranë vetëm pas nëntë muajve, çka tregon se, megjithëse nuk pati një prishje formale të marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Turqisë, në të vërtetë marrëdhëniet midis dy vendeve ishin ngrirë.

Më 22 maj 1930, në një bisedë jo zyrtare të Rauf Ficos me një personalitet turk, emri i të cilit nuk bëhet i ditur, ministri shqiptar i deklaroi atij se, qeveria shqiptare duke qenë e detyruar të bënte kursime të mëdha në buxhet, do të syprimonte edhe konsullatën e Stambollit dhe se detyrat e saj për mbrojtjen e shtetasve shqiptarë, mendonin t'ia ngarkonin një shteti tjetër. Duke pasur parasysh lidhjet e përzemërta mes dy kombeve, ai shprehu ndjenjat e tij të sigerta dhe miqësore lidhur me Turqinë, dhe kërkoi nga diplomati turk që t'i jepej fund një orë e më parë gjendjes aktuale. “Jam më se i sigurt -vijoi më tej Rauf Fico- se me të njëjtat ndjenja janë të frymëzuar edhe anëtarët e tjerë të qeverisë turke, e veçanërisht Shkëlqesia e Tij, Ismet Pasha dhe Teufik Ryshty beu”.⁴⁸ Nga ana e tij, personaliteti turk, pasi iu përgjigj se nuk mund ta dinte se ç'qëndrim reciprociteti do të mbante qeveria e tij republikane, shtoi se Shqipëria ishte aleate e natyrshme e Turqisë; se lidhja e miqësisë midis dy vendeve ishte më e fortë se çdo traktat aleance dhe kjo lidhje nuk mund të shkëputej për asnjë shkak; sepse miqësia shqiptaro-turke mbështetej në interesa e ndjenja reciproke⁴⁹. Si argument ai solli dhe qëndrimin e qeverisë së tij ndaj antizogistëve që ndodheshin në Turqi, e veçanërisht kortezinë që qeveria turke tregonte duke e mbajtur të hapur ambasadën e saj në Tiranë, çka nënkuptonte se, në mos zyrtarisht, në mënyrë të tërthortë, ajo e njihte regjimin e Monarkisë. Prandaj, ai mendonte se nuk do të ishte një politikë e matur nga pikëpamja e interesave të të dyja palëve, që tani për tani të këmbëngulej në çështjen e njohjes zyrtare të monarkisë. Më poshtë ai shtronte dhe pyetjen se, cili do të ishte qëndrimi i qeverisë shqiptare nëse qeveria e tij do të dëshironte ta mbante të hapur ambasadën e saj në Tiranë dhe të ruante statukuonë e rezidencave. Megjithëse nga ana e Rauf Ficos nuk jepet ndonjë përgjigje

⁴⁷ *Po aty*, D.178, V.1930, fl.7; Gazeta “*Belfast News Letter*”, 9.1.1930.

⁴⁸ *Po aty*, fl.4, Raport në osmanisht mes një personaliteti turk dhe ministrit të Punëve të Jashtme Rauf Ficos, 22.5.1930.

⁴⁹ *Po aty*.

konkrete, fakti që legata turke vazhdoi të mbetej e hapur në Tiranë, ndonëse me një aktivitet të kufizuar ose pothuajse inekzistent, tregon se ky ishte një *modus vivendi* derisa në një të ardhme të afërt gjërat të rregulloheshin.

Rivendosja e marrëdhënieve shqiptaro-turke

Rreziku i ekspansionit gjerman e italian i detyroi vendet e Ballkanit, me gjithë kontradiktat e mëdha në mes tyre, të mblidheshin për të gjetur rrugët e një bashkëpunimi që do të kishte bazë mbrojtjen e përbashkët. Për herë të parë u krijuan mundësitë që qeveritë e vendeve ballkanike të mblidheshin për të rregulluar marrëdhëniet midis tyre dhe të krijonin njëfarë fronti për të mbrojtur interesat rajonale.⁵⁰ Nismën për këtë e mori ish kryeministri grek A.Papanastasiu në Kongresin e XXVII Universal të Paqes që u mbajt në Athinë në tetor 1929. Iniciativa greke nuk u kundërshtua nga vendet e tjera ballkanike. Ato iu përgjigjën ftesës së organizatorëve për të marrë pjesë në Konferencën e Parë Ballkanike që do të hapej në Athinë në tetor 1930.⁵¹ Për të krijuar një klimë bashkëpunimi paraprakisht u vendos që këto vende të përfaqësoheshin në konferencë nga delegacione jozyrtare dhe që vendimet e tyre të kishin vetëm karakter këshillues.

Megjithëse në momentet e para pati debate për të marrë ose jo pjesë në këtë eveniment,⁵² pjesëmarrjen në Konferencën I Ballkanike dhe më vonë aderimin e Shqipërisë në Paktin Ballkanik, Mbreti Zog e shihte si një rast për të demonstruar pavarësinë e tij në fushën e politikës së jashtme⁵³ dhe si një rrugëdalje për të zvogëluar, në mos për të eliminuar krejtësisht, ndikimin italian.⁵⁴

⁵⁰ Barbara Jelavich, *History of the Balkans*, New York: Cambridge University Press, 1983, p.212.

⁵¹ Paskal Milo, "Shqipëria dhe Aleanca Ballkanike", *Studime Albanologjike*, nr.1, Tiranë: 1997, f.57.

⁵² Beqir Meta, "Debatit shqiptaro-grek për problemet e minoriteteve dhe të Kishës Autoqefale Shqiptare në organizmat ndërkombëtare në vitet 1929-1934", *Studime Historike*, nr.3-4/2010, Tiranë: 2011, f.49.

⁵³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: "Toena", 2007, f.308.

⁵⁴ Bernd J. Fischer, *King Zog and the Struggle for Stability in Albania*, New York: Columbia University Press, 1984, p.222.

Delegacioni shqiptar që do të merrte pjesë në Konferencën II Ballkanike, mbërriti në Stamboll më 17 tetor 1931.⁵⁵ Konferenca i filloi punimet më 20 tetor në pallatin Dolmabahçe Sarayı (Dollmabahçe), në të cilin merrnin pjesë gjashtë vende ballkanike me mbi 200 përfaqësues⁵⁶.

Në një intervistë që kryetari i delegacionit shqiptar Mehmet Konica dha për gazetën “Cumhuriyet” (“Republika”) gjatë punimeve të konferencës, deklaroi ndër të tjera se, megjithëse Shqipëria ishte një mbështetëse e zjarrtë e bashkimit ballkanik, përsëri ajo ngulte këmbë se pa ju dhënë të drejtat rreth 1 milion shqiptarëve të Jugosllavisë, Shqipëria ishte e pamundur të pranonte bashkimin e vendeve të Ballkanit. Pyetjes së gazetarit turk nëse besonte në bashkimin ballkanik, Mehmet Konica iu përgjigj se nuk kishte shumë besim se kjo do të arrihej.⁵⁷ Megjithatë, të biseduarit e anëtarëve të delegacionit shqiptar me gazetarët turq, në gjuhën turke, kishte ngjallur simpati shumë të madhe.⁵⁸

Në përfundim të Konferencës II Ballkanike, pritej që të gjithë delegacionet e vendeve pjesëmarrëse të niseshin për një vizitë kortezie drejt Ankarasë. Duke u nisur nga kjo, kryetari i delegacionit Mehmet Konica, më 20 tetor 1931 i raportoi ministrit të Punëve të Jashtme Hysen Vrioni se delegacioni shqiptar ishte pritur në një mënyrë shumë të sinqertë. Autoritetet turke kishin treguar një afrimitet të madh dhe se ministri i Punëve të Jashtme i kishte deklaruar atij se mosnjohja e regjimit kishte pasur arsye të brendshme dhe se tani që ato ishin zhdukur puna do të ndreqej. Refuzimi i ftesës për të shkuar në Ankara, sipas Mehmet Konicës, do të linte një përshtypje të keqe. Edhe ministri i Italisë ishte i mendimit se në Ankara duhej vajtur medoemos.⁵⁹ Në përgjigje të kësaj kërkese, vetëm një ditë më pas, Mehmet Konica u urdhërua që të shkonte në Ankara vetëm nëse çështja e minoriteteve do të përfundonte në favor të tezës shqiptare dhe në rast se çështja e regjimit ishte *déjà vu*. Pra, ishte vendosur që të njihej, por, dhe kjo me kusht që atje, ai të mos mbante asnjë fjalim. Në të kundërtën, nëse çështja e minoriteteve do të shkaktonte largimin e delegacionit shqiptar nga konferenca, atëherë vajtja

⁵⁵ *Hakimiyet-i Milliye*, 18 Ekim 1931, s.1.

⁵⁶ *Milliyet*, 21 Ekim 1931, s.1.

⁵⁷ *Cumhuriyet*, 18 Ekim, 1931, s.3.

⁵⁸ *BCA*, 15 Aralık 1931, 030.10, yer no: 233.570.15: 11-12.

⁵⁹ *AMPJ*, D.90, V.1931, fl.20, Raport i kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Dytë Ballkanike, Mehmet Konica, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 20.10.1931.

e tij në Ankara s`do të kishte asnjë kuptim, sepse edhe misioni i delegacionit konsiderohej i përfunduar.⁶⁰

Por, meqenëse çështja e pakicave u vendos që të merrej parasysh, më 25 tetor 1931 delegacioni shqiptar së bashku me delegacionet e tjera të vendeve ballkanike u nis nga Stambolli drejt Ankarasë.⁶¹ Në pritjen e rastit që u zhvillua në mjediset e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, më 26 tetor 1931, merrte pjesë personalisht edhe Mustafa Qemali, Kryetari i Asamblesë dhe ministri i Punëve të Jashtme Tevfik Rüşti Aras. Për koïcidencë, në bazë të renditjes alfabetike të vetë shteteve, duke përshëndetur të sipërpërmendurit, hynë fillimisht anëtarët e delegacionit shqiptar.⁶²

Në fjalën e tij të mirëseardhjes Presidenti i Republikës Turke, Mustafa Qemali, pasi përmendi faktin se popujt dhe shtetet ballkanike si Shqipëria, Bullgaria, Rumania, Greqia, Jugosllavia dhe Turqia gëzonin një pavarësi të plotë politike, bëri thirrje që në emër të interesave të përbashkëta rajonale këto shtete duhet ta rrisnin bashkëpunimin me njëri-tjetrin.⁶³

Megjithëse që në fillim të saj, Mbreti Zog dhe qeveria shqiptare ishin skeptikë ndaj rezultateve të Konferencës II Ballkanike,⁶⁴ duke pranuar që Shqipëria të merrte pjesë në këtë konferencë u mendua të arrihej edhe një qëllim tjetër, ta vinin Turqinë përpara situatës faktike, që ta njihte zyrtarisht Mbretërinë Shqiptare. Po ato ditë ministri anglez në Shqipëri, i shkruante Forin Ofisit: “Duke qenë se gaziu kishte refuzuar ta njihte Mbretin Zog në një çast zemërimi, por jo për ndonjë shkak të arsyetuar politik, ishte e nevojshme të pritej një çast i volitshëm për rifillimin e marrëdhënieve diplomatike. Një çast që do ta lejonte atë të ndryshonte mendim pa u turpëruar. Ky rast u paraqit me mbajtjen e Konferencës Ballkanike në Stamboll”⁶⁵, në kuadër të së cilës, Mustafa Qemali, në emër të tij dhe të kombit turk, i dërgoi nga një telegram urimi të gjithë

⁶⁰ *Po aty*, fl.21, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, për Mehmet Konicën, 21.10.1931.

⁶¹ *Hakimiyet-i Milliye*, 25 Ekim 1931, s.1.

⁶² *Cumhuriyet*, 27 Ekim, 1931, s.3.

⁶³ *Po aty*, s.1.

⁶⁴ “Konferenca Ballkanike ishte e destinuar të dështonte dhe ja dështoi”, *Besa*, nr.86, 29 tetor 1931, f.2.

⁶⁵ Foreign Office (FO) 637/103/1181/24, Letër e R.M.Hodgson për Markezsin Reading, 3.11.1931.

kryetarëve të vendeve pjesëmarrëse në Konferencën II Ballkanike.⁶⁶ Në telegramin e tij drejtuar Mbretit Zog, më 26 tetor 1931, ai shkruante me nota miqësore ndaj tij dhe kombit shqiptar.⁶⁷ Po në të njëjtën ditë, kryetari i delegacionit shqiptar Mehmet Konica, plot entuziazëm i telegrafoi nga Ankaraja Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë si më poshtë: “Pritje intime. Të njohurit u bë. I lutemi Mbretit nxehëtishtë me iu përgjegj telegramit të Mustafa Qemal Pashës. Sa më shpejt dhe në mënyrën më intime, që kështu të fillojnë relacionet zyrtare”.⁶⁸

Pas telegramit për Mbretin Zog, Mustafa Qemali priti në audiencë delegacionin shqiptar, sëbashku me të cilin merte pjesë edhe kryeredaktori i gazetës “Miku i Popullit” Nebil Çika.⁶⁹ Presidenti i Republikës Turke i deklaroi delegacionit se do të bënte çdo përpjekje që Shqipëria të bëhej pjesë e bashkimit midis vendeve të Ballkanit.⁷⁰

Nuk vonoi shumë dhe më 29 tetor 1931 edhe Mbreti Zog iu përgjigj me një mesazh po aq miqësor Ataturkut.⁷¹ Po atë ditë i Ngarkuari me

⁶⁶ *Cumhuriyet*, 28 Ekim, 1931, s.1.

⁶⁷ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok. nr. 394, s.304-305; *Cumhuriyet*, 31 Ekim, 1931, s.3; “Drejt njoftjes së regjimit tonë nga Turqia-Telegramet e këmbyme midis Presidentit të Republikës Turke dhe Mbretit t'onë”, *Besa*, nr.85, 28 tetor 1931, f.1.

“Nalt Madhniis së Tij Zog I Mbretit të Shqiptarëve
Tiranë

Ndjeva një kënaqësi të vërtetë kur pranova sot në Ankara anëtarët e Konferencës Ballkanike. U preka shumë për urimet që shfaqën për personin tim dhe për kombin Turk, përfaqësuesit e bashkuar të organizatave kombëtare të Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë, Rumanisë, Jugosllavisë dhe Turqisë.

Duke formuluar me këtë rast urimet më të sinqerta për lumturinë personale të Lart Madhërisë t'Uaj dhe për mbarëvajtjen e kombit bujar shqiptar, shpreh jo vetëm ndjenjat e mija personale por edhe ato të gjith kombit Turk...

Gazi Mustafa Qemal”.

⁶⁸ *AMPJ*, D.90, V.1931, fl.22, Telegram i kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Dytë Ballkanike, Mehmet Konica, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 26.10.1931.

⁶⁹ *BCA*, 15 Aralık 1931, fon kodu:030.10, yer no: 233.570.15: 7-10.

⁷⁰ *BCA*, 15 Aralık 1931, 030.10, yer no: 233.570.15:13.

⁷¹ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok. nr. 395, s.305; *Cumhuriyet*, 31 Ekim, 1931, s.3; “Drejt njoftjes së regjimit tonë nga Turqia-Telegramet e këmbyme midis Presidentit të Republikës Turke dhe Mbretit t'onë”, *Besa*, nr.85, 28 tetor 1931, f.1.

“Shkëlqesis së Tij Gazi Mustafa Qemal Pasha
Kryetar i Republikës Turke

Punë i Turqisë në Tiranë, Zeki Haki beu, vajti në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe deklaroi se kishte marrë instruksione prej qeverisë së vet, që të hynte në marrëdhënie zyrtare me qeverinë mbretërore shqiptare.⁷² Hapin e diplomatit turk, Zyra shqiptare e Shtypit nxitoi t'ua njoftonte të gjitha agjencive të huaja, si hapjen e një periudhe të re midis dy vendeve. Arsyet e vonësës së njohjes së regjimit mbretëror shqiptar prej Republikës Turke, sipas një interviste që vetë Mustafa Qemali i dha ato ditë gazetarit Nebil Çika, kishin qenë arsye politike të brendshme. Meqenëse çështja qëndronte kështu-komentonte gazeta "Vullneti i Popullit"-nuk pritej veç se një rast për t'a hedhur çapin definitiv. Dhe ky rast iu dha me vajtjen e delegatëve tonë për Konferencën Ballkanike.⁷³

Rivendosjes së marrëdhënieve shqiptaro-turke ju bë jehonë e madhe nga shtypi shqiptar.⁷⁴ Nuk munguan dhe shkrime të cilat e vinin theksin se për këtë, një mirënjohje e veçantë, si ndjenjë karakteristike e popullit shqiptar, duhej t'i njihej Italisë, e cila, si aleate e shtetit dhe e popullit shqiptar kishte dhënë një ndihmë të madhe me anë të përfaqësuesit të saj në Ankara.⁷⁵

Më 14 nëntor 1931, ministri i Punëve të Jashtme Hysen Vrioni njoftoi me anë të një shkrese ministrin e Oborrit Mbretëror se i Ngarkuari me Punë i Turqisë, Zeki Haki beu, i kishte drejtuar kësaj ministrie një shkresë ku kërkonte që të pranohej në audiencë prej Mbretit Zog, duke iu lutur këtij dikasteri që të ndërmjetësonte pranë Mbretit për akordimin e kësaj audience.⁷⁶ Me rastin e festës së pavarësisë, më 28 nëntor 1931, ndryshe nga vitet e tjera, i Ngarkuari me Punë i Turqisë Zeki Haki beu

Ankara

U preka shumë nga urimet që Shkëlqesia Juaj pati mirësinë të shprehë kundrejt kombit shqiptar dhe personit tim me rastin e mbledhjes së Konferencës së Dytë Ballkanike. Në emrin tim dhe në atë të kombit shqiptar formoj urimet më të sinqerta për lumturinë personale të Shkëlqesis s'Uaj dhe për mbarëvajtjen e kombit bujar Turk.

Ahmet Zogu".

⁷² AMPJ, D.90, V.1931, fl.23, Njoftim i Zyrës së Shtypit, 29.10.1931.

⁷³ Vullneti i Popullit, nr.416, 1.11.1931, f.1.

⁷⁴ BCA, 15 Aralık 1931, 030.10, yer no: 233.570.15, s.3-6.

⁷⁵ "Afrimi Shqiptaro-Turk dhe përkrahja e Aleates së Madhe", Vullneti i Popullit, nr.417, 4.11.1931, f.4.

⁷⁶ AMPJ, D.90, V.1931, fl.28, Letër e ministrit të Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, për ministrin e Oborrit Mbretëror, 14.11.1931.

mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga Oborri Mbretëror, ku pati rastin të shtërngonte dorën dhe me Mbretin Zog, i cili, duke buzëqeshur nuk harroi ta pyeste edhe për Mustafa Qemalin. Në ballon e organizuar me këtë rast, ai takoi ministrin e Oborrit dhe disa ministra të tjerë, të cilët gjithashtu, i shfaqën nderime të posaçme. Pas këtyre zhvillimeve ai i raportoi Ankarasë se për punë ditësh ishte në pritje të një audience me Mbretin.⁷⁷

Kjo klimë miqësie, e krijuar ndaj përfaqësuesit të Republikës Turke në Tiranë, kishte ngjallur interes të veçantë në Ankara. Ministri i Punëve të Jashtme, Tevfik Rüştü Aras i shkruante Zeki Haki beut se, fjalët e ngrohta (nga ana e Mbretit Zog-H.B.) për Presidentin e Republikës dhe për popullin turk ia kishte përcjellë Mustafa Qemalit, i cili, ishte kënaqur shumë dhe kishte urdhëruar që të njëjtat ndjenja miqësore t'i përcillnin nga ana e tij edhe Mbretit Zog.⁷⁸

Më 5 dhjetor 1931, Mbreti Zog, për herë parë pas katër vjetësh priti në audiencë të Ngarkuarin me Punë të Turqisë, Zeki Haki beun. Sipas raportit të diplomatit turk, Mbreti Zog, me një turqishte elokuate dhe me një sinqeritet të jashtëzakonshëm, i kishte deklaruar atij se, Shqipërinë e lidhnin me Turqinë lidhje të shenjta, të cilat kurrë nuk mund të prekeshin dhe se, personalisht ishte gëzuar shumë për kapërcimin e keqkuptimeve dhe për njohjen e regjimit. Mbreti Zog, i kishte shprehur gjithashtu nderimet që ai ndjente për Ataturkun, si dhe për ato që ai kishte bërë për zhvillimin e Turqisë. Në fund të bisedës, në shenjë miqësie ai i kishte deklaruar Zeki Haki beut se atë nuk e konsideronte si një diplomat të huaj dhe se për çdo mosmarrëveshje që mund t'i dilte me ministrin e Jashtëm të mos ngurronte e të vinte direkt tek ai për ta zgjidhur. Duke e përcjellë, edhe një herë ai nuk kishte harruar t'i shprehte respektet e tija për Mustafa Qemalin.⁷⁹

Në një takim të dytë që Zeki Haki beu realizoi me Mbretin Zog më 12 dhjetor 1931, për t'i transmetuar atij mesazhin e mësipërm të ministrit të Punëve të Jashtme Tevfik Rüştü Aras, Mbreti në shenjë miqësie edhe njëherë i deklaroi atij se Turqia për Shqipërinë dhe Shqipëria për Turqinë

⁷⁷ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok.nr.398, s.311.

⁷⁸ *Po aty*, dok. nr. 399, s.311.

⁷⁹ *Po aty*, dok. nr. 400, s.311-312.

ishin aleatë të natyrshëm dhe se Gaziut (Mustafa Qemalit-H.B.) ai do t'i mbesë përgjithmonë besnik.⁸⁰

Dekretin për rihapjen e Legatës Shqiptare në Ankara, Mbreti Zog e lëshoi më 28 janar 1932. Ndërsa, më 20 shkurt, Nezir Leskoviku i dorëzoi ministrit të Punëve të Jashtme të Turqisë, Şükrü Kaya (Shykry Kaja), letrën akreditive.⁸¹ “Zotni e tij-raportonte Nezir Leskoviku-më pritë me një kordialitet të veçantë dhe më tha se kurdoherë që kishte patur rastin, dëshirën e tij ia kishte shfaqur dhe Gaziut. Më shtoj se në Turqi ka një kënaqësi të madhe për rifillimin e relacioneve...Po dhe në Shqipëri iu përgjigja Kaja beut një kënaqësi të atillë ka, mbasi dhe relacionet rifilluan në një mënyrë të pëlqyeshme”⁸². Një qëndrim po aq miqësor ndaj Nezir Leskovikut tregoi edhe kryeministri Ismet Pasha. Më 10 mars 1932, në një bisedë që ai zhvilloi me diplomatit shqiptar, e pyeti këtë të fundit për traktatet me Italinë dhe veçanërisht mbi efektet e krizës financiare që atëherë kishte përfshirë mbarë botën. “Sa për të premunit e relacioneve tona më parë-vijonte Nezir Leskoviku-sa shof e kuptoj, turqit tani janë të penduem nga sjellja e tyre dhe këtë në çdo rast e tregon pak a shumë qëndrimi miqësor që shfaqin ndaj titullarit të kësaj legate”⁸³.

Më 19 mars 1932, përfaqësuesi i Shqipërisë në Sofje, raportoi mbi një bisedë që kishte zhvilluar me ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Tevfik Rüştü Aras, i cili, i ishte lutur diplomatit shqiptar që t'i transmetonte Mbretit Zog sigurimet e nderimet e tij më të thella dhe admirimin e tij të posaçëm. Midis të tjerave, ai, kishte deklaruar se po priste me padurim dërgimin e një ministri të Shqipërisë në Ankara, pas të cilit, edhe ai menjëherë do të dërgonte një ministër në Tiranë.⁸⁴

⁸⁰ *BCA*, 4 Ocak 1933, fon kodu: 030.10, yer no: 233.570.22.

⁸¹ Shykri Kaja beu ishte ministër i Punëve të Brendshme, por herë pas here ishte ngarkuar nga qeveria turke të ushtronte njëkohësisht edhe detyrën e ministrit të Jashtëm. Ai pati kryesuar delegacionin turk në bisedimet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë në vitin 1923. Me Nezir Leskovikun ai kishte miqësi të vjetër, pasi që të dy kishin qenë kolegë (nëpunës) në Vilajetin e Izmirit.

⁸² *AMPJ*, D.132, V.1932, fl.3, Raport i Nezir Leskovikut nga Ankaraja për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 21.2.1932.

⁸³ *Po aty*, D.135, V.1932, fl.4-5, Raport i të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Ankara, Nezir Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 11.3.1932.

⁸⁴ *Po aty*, D.88, V.1932, fl.10, Raport i përfaqësuesit shqiptar në Sofje, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 19.3.1932.

Më 25 mars 1932, Tevfik Rüştü Aras, realizoi një takim tjetër me Nezir Leskovikun, ku pasi i tregoi mbi shkurtimin e buxhetit të Turqisë si rezultat i krizës ekonomike, e hodhi fjalën në Konferencën III të Vendeve Ballkanike që do të mbahej së shpejti në Bukuresht, duke sugjeruar që në mbledhjen e ardhshme të mos bëheshin bisedime politike ose, mbledhjen ta shtynin dhe një vit, në mënyrë që të evitoheshin konfliktet midis popujve që ishin egërsuar si rezultat i krizës. “Nga fjalët e Teufik Ryshty beut-shkruante Nezir Leskoviku-kuptohet se ky mendim fillimisht ka dalë nga serbët, ashtë pëlqye nga turqit dhe kështu duan që dhe Shqipëria me Bullgarinë ta pranojnë. Qëllimi i Serbisë asht i ditun, por, dhe i Turqisë. Asaj mbasi nuk i ka mbet ndonjë çështje kombësie irredente, dhe mbasi i duhet një paqe dhe qetësi e gjatë për me i mujt me i nxjerrë në krye gjithë veprimet e reformave të saja, nuk i pëlqen aspak të dëgjojë çështje turbullimi rreth kufinit, megjithëse në Ballkan do të ketë një influencë”.⁸⁵ Ftesës së bërë nga Mbreti Zog, për të bërë një vizitë në Shqipëri, Ismet Pasha dhe Tevfik Rüştü Aras nuk iu përgjigjën. Ata ende nuk qenë të qartë nëse ishte apo jo tani koha e përshtatshme për këtë vizitë. Këtë gjë ata do ta bisedonin dhe me Mustafa Qemalin.⁸⁶

Në kuadër të afrimit të mëtejshëm shqiptaro-turk, më 5 prill 1932, ministri i Punëve të Jashtme, Hysen Vrioni kërkoi leje nga Këshilli i Ministrave që të bënte një sondazh pranë qeverisë turke, lidhur me ratifikimin nga të dyja palët të Konventës Konsullore, e cila, megjithëse ishte nënshkruar që më 11 korrik të vitit 1927, për shkak të ngrirjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Turqisë, nuk i ishte paraqitur ende Parlamentit për t`u ratifikuar.⁸⁷ Vetëm pas disa ditësh me vendim nr.358, datë 14.5.1932, Këshilli i Ministrave autorizoi ministrin e Punëve të Jashtme që të hynte menjëherë në marrëveshje me qeverinë turke, për ratifikimin e Konventës Konsullore.⁸⁸

Më 4 qeshor 1932, nga konsullata shqiptare e Stambollit, Asaf Xhaxhuli raportoi se Tevfik Rüştü Aras, i kishte deklaruar atij se megjithëse ishte i kënaqur me Zeki Haki beun, në Tiranë mendonte të

⁸⁵ *Po aty*, D.135, V.1932, fl.7-8, Raport i të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Ankara, Nezir Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 25.3.1932.

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ *Po aty*, D.132, V.1932, fl.4, Letër e ministrit të Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, për Këshillin e Ministrave, 5.4.1932.

⁸⁸ *Po aty*, fl.5, Vendim i Këshillit të Ministrave, 14.5.1932.

dërgonte një titullar më me experience,⁸⁹ ç`ka nënkuptonte se tani Turqia kërkonte ngritjen dhe forcimin e mëtejshëm të nivelit të marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve, nga niveli i të ngarkuarve me punë, në nivel ambasadorësh.

Ringritja e nivelit të marrëdhënieve shqiptaro-turke dhe Konferenca III Ballkanike

Konferenca III Ballkanike i zhvilloi punimet në Bukuresht nga data 22 deri më 29 tetor 1932. Disa muaj para se të mblidhej Konferenca e Bukureshtit, grupi shqiptar u informua se ministrat e Jashtëm të Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë kishin deklaruar se në këtë konferencë nuk do të diskutoheshin çështjet politike, por ajo do të merrej vetëm me problemet ekonomike, çka do të thoshte se problemi i Paktit Ballkanik dhe ai i minoriteteve nuk do të diskutoheshin. Delegacioni shqiptar u dërgoi pesë grupeve të tjera një letër në të cilën shpjegonte se, nëse nuk do të diskutohej projekti i Paktit, grupi shqiptar nuk do të merrte pjesë në konferencë. Katër grupet e tjera u përgjigjën se projekti i Paktit do t'i paraqitej konferencës.⁹⁰

E vetmja pengesë serioze për afrimin e vendeve të Gadishullit Ballkanik, vazhdoi të mbetej çështja e pakicave. Shtetet që interesoheshin më shumë për këtë çështje dhe që zgjidhjen e së cilës e vinin si një konditë të domosdoshme për marrëveshjen ballkanike ishin Shqipëria me Bullgarinë.⁹¹ Projekt-Pakti u pranua dhe u vendos që t'u paraqitej qeverive të vendeve pjesëmarrëse për ta shqyrtuar. Por, delegacioni jugosllav nuk pranoi që në Projekt-Paktin Ballkanik të futej neni që parashikonte mbrojtjen e pakicave kombëtare, kështu delegacioni shqiptar s`bëri lëshim. Në fjalën e tij, kryedelegati Mehmet Konica u shpreh se: “Delegacioni shqiptar ka deklaruar që në Konferencën I Ballkanike dhe qëndron akoma në mendimin se zgjidhja e të drejtave të pakicave kombëtare ka qenë dhe mbetet kushti *sine qua non* i bashkimit ballkanik. Një bashkim pa garanci për të drejtat e tyre do të ish jetëshkurtër. Nëse Pakti Ballkanik s`do aprovohet para tetorit të vitit të ardhshëm nga qeveria jonë, them me keqardhje se grupi kombëtar

⁸⁹ *Po aty*, D.133, V.1932, fl.3, Raport i Asaf Xhaxhulit nga Stambolli, për ministrin e Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, 4.6.1932.

⁹⁰ B. Meta, “Debati shqiptaro-grek...”, f.56.

⁹¹ *BCA*, 21 Kasim 1932, fon kodu: 030.10, yer no: 251.694.27.

shqiptar s`do marrë pjesë në vazhdimin e punimeve të kësaj konference, duke e konsideruar se s`ka asnjë arsye që kjo të ekzistojë”.⁹²

Më 19 mars 1933 delegacionet zhvilluan mbledhjen e fundit dhe më pas u shpërndanë me dëshirën për t`u ritakuar përsëri në Konferencën IV Ballkanike, që kësaj radhe do të mbahej në Selanik.

Po në ditët e para të muajit mars 1933, ministri i Punëve të Jashtme Xhaferr Vila ftoi për një vizitë të Ngarkuarin me Punë të Turqisë, të cilit, i bëri të ditur se Mbreti Zog kishte vendosur të ngarkonte me detyrën e përfaqësuesit të Shqipërisë në Ankara, Xhavit Leskovikun, që deri atëherë mbante detyrën e kryekonsullit të Shqipërisë në Shkup, duke kërkuar që për këtë të dinte edhe mendimin e qeverisë turke.⁹³

Propozimi i palës shqiptare u mirëprit nga Ankaraja, e cila, kishte qenë vetë e para që kishte dhënë sinjalet për një gjë të tillë.

Pas dekretimit nga ana e Mbreti Zog, Xhavit Leskoviku, u nis drejt Turqisë dhe më 14 maj 1933 u prit në audiencë nga Mustafa Qemali, të cilit, i dorëzoi letër-kredencialet.⁹⁴

⁹² *Po aty*; “Konferenca III Ballkanike - Pse s`qenë dakord delegatat shqiptare e bullgare?”, *Minerva*, nr.4-5, 28 nëntor 1932, f.35.

⁹³ *Cumhurbaşkanlığı Arşivi* (Arkivi i Republikës Turke), 4 Mart 1933, IV-6, 54, 20-1-2.

⁹⁴ B.N. Şimşir, *Atatürk ve yabancı...*, dok. nr. 408, s.318-320; *Hakimiyet-i Milliye*, 15 Mayıs 1933, s.2.

“Shkëlqesis së Tij

Presidentit të Republikës Turke

Kam nderin t`i paraqes Shkëlqesis Tuaj letrat me të cilat sovranit jonë August, Nalt Madhnija e Tij Mbreti i Shqiptarëve më ka akredituar pranë Shkëlqesis Tuaj si i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë. Jam fatbardhë që m`u dha rasti t`u parashtrij në emër të sovranit tim August shprehjet e Tij...Ndjenja të thella dashurije të pandryshueshme të vëllazëris dhe të miqësis së patundshme...”

Ndërsa Presidenti i Republikës Turke, Mustafa Qemali, në fjalën e tij të rastit i deklaroi ministrit shqiptar Xhavit Leskoviku, se:

“I mar me gëzim letrat me anë të të cilave Mbreti Shqiptar ka akredituar Shkëlqësin Tuaj si i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë.

Më kanë impresionuar veçanërisht shprehjet fisnike që më bëtë në emër të Sovranit t`uaj August për Republikën Turke dhe për personin tim. Në këto shprehje jam duke konstatuar pasqyrimin me sinjeritet të ndjenjave më të larta admiruese që ushqej për kombin hero shqiptar dhe për personin e tij të shquar. Traditat miqësore reciproke, të të dy kombeve të lidhur me njëri-tjetrin me lidhje të singerta shekullore, janë shumë të forta. Gjithashtu zoti Ministër në kryerjen e detyrës tuaj të lartë do të keni gjithmonë përkrahjen time dhe të Qeverisë Republikane”.

Shtypi turk i bëri jehonë të madhe rihapjes së legatës shqiptare në Ankara. Më 26 maj 1933, gazeta “Cumhuriyet” (“Republika”), botoi dhe një intervistë të ministrit shqiptar Xhavit Leskoviku, i cili, pasi ngrinte lart miqësinë e hershme midis dy vendeve, hidhte idenë që në këtë kohë krize do të ishte në interes të të dyja shteteve që së bashku të nënshkruanin edhe një marrëveshje të përbashkët tregtie.⁹⁵

Në princip të politikës së jashtme të Republikës Turke tani ishte ndërtimi i marrëdhënieve miqësore me të gjitha shtetet fqinje dhe sidomos me ato ballkanike, ku ajo pretendonte të luante një rol më aktiv.⁹⁶ Në këtë kuadër, në qershor të vitit 1933, ministri i Jashtëm Tevfik Rüştü Aras i propozoi të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Londër për të lidhur një pakt miqësie, aleance dhe sigurimi midis Shqipërisë, Turqisë dhe Greqisë. Ky propozim, u mirëprit nga pala shqiptare. Më 24 qershor 1933, Ministria e Punëve të Jashtme i telegrafoi Legatës Shqiptare në Londër, se: “Në gjinden akoma aty, ju lutem lajmëroni MPJ të Turqisë se Qeveria Shqiptare është dakord me mendimin e tij për lidhjen e një pakti miqësie, aleance dhe arbitrazhi midis Shqipërisë, Turqisë dhe Greqisë”⁹⁷. Por, meqenëse atë ditë Teufik Ryshty beu ishte larguar nga Londra, kjo detyrë iu ngarkua ministrit Shqiptar në Ankara, Xhavit Leskovikut, i cili, u takua me Teufik Ryshty beun më 24 korrik 1933. Përgjatë bisedës, Tevfik Rüştü Aras i deklaroi ministrit shqiptar se kjo aleancë duhej të quhej pakt mos-sulmimi dhe se një gjë e tillë do ta fuqizonte independencën dhe prestigjin e Shqipërisë, të cilën, Turqia e dëshironte më së tepërmi.⁹⁸ Nga bisedimet e mësipërme dukej qartë se tensioni në marrëdhëniet shqiptaro-turke tashmë kishte marë fund, duke përruarur kështu, një fazë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve.

⁹⁵ *Po aty*, dok. nr. 409, s.319-320.

⁹⁶ Sevim Ünal, “Atatürk`ün Balkanlar`daki Barışçıl Politikası”, *IX. Türk Tarih Kongresi*, III. Cilt, Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1989, s.1993.

⁹⁷ *AMPJ*, D.240, V.1933, fl.9, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme për Legatën Shqiptare në Londër, 24.6.1933.

⁹⁸ *Po aty*, D.243, V.1933, fl.37, Raport i ministrit shqiptar në Ankara Xhavit Leskoviku, për ministrin e Punëve të Jashtme Xhaferr Vila, 1.8.1933.

S u m m a r y

THE TENSE RELATIONS BETWEEN THE ALBANIAN MONARCHY
AND THE TURKISH REPUBLIC
(1928-1933)

On the 1st September 1928, the Constitutional Assembly approved unanimously the new constitution which proclaimed Albania a Parliamentary Democratic Hereditary Monarchy, and chose as king of the Albanians his highness Zog I. Shortly after, all the European countries started to recognize, one after the other, the Albanian Monarchy and King Zog, except for Yugoslavia and Turkey. While Yugoslavia considered the proclamation of King Zog I as “King of the Albanians” as an ambition to include in his kingdom the Albanian territory and population that was politically part of the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes, the reasons for the hesitation of Turkey, as defined by Mustafa Kemal in a later interview given for the Albanian journalist Nebil Çika, were internal and political.

Despite the tense diplomatic relations between the two countries from 1928-1933, they were not completely interrupted. The withdrawal of the Turkey’s minister Tahir Lutfi bey from Albania was followed by the withdrawal from Turkey of the Albania’s minister Rauf Fico, whom King Zog appointed Minister of Foreign Affairs in the new cabinet. This marked the deterioration of the diplomatic relations and the two countries were respectively represented by their secretaries of legations. The improvement of the relations between the two countries would come with the Balkan Conferences, in which both countries participated, and with the new atmosphere of collaboration at the beginning of the 1930s.